



STANDARTET MINIMALE DHE PARIMET DREJTUESE TË PIKAVE KOMBËTARE TË KONTAKTIT NCP

PËR PROGRAMIN KUADËR TË BE-së PËR KËRKIM SHKENCOR DHE INOVACIONIN HORIZON 2020

1.Konteksti

Për Programin Kuadër të BE për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin do të krijohet një rrjet i Pikave Kombëtare të Kontaktit (NCP), mbështetur në eksperiencën e mëparshme të Programeve Kuadër të BE-së për Kërkim Shkencor. Në mënyrë që të nxitet një pjesëmarrje e barabartë dhe mbështetje e vazhdueshme, ky dokument ofron një informacion të njëjtë për të gjitha vendet pjesëmarrëse në këtë program.

2.Qëllimi

Shërbimet mbështetëse profesionale të nivelit të lartë që do të realizohen në nivel kombëtar për këtë program (H2020), do të përbëjnë një element të rëndësishëm për zbatimin e tij. Duke ndërgjegjësuar grupet e interesit për të marrë pjesë në këtë program, përmes ofrimit të këshillave profesionale dhe praktike edhe në terren, Pikat Kombëtare të Kontaktit (NCP) do të bëjnë të mundur që ky program i ri të bëhet i njohur dhe të jetë i prekshëm nga të gjithë aplikantët e mundshëm, pavarësisht fushës së kërkimit shkencor së cilës ata i përkasin

3.Parimet bazë dhe standartet minimale

Për Rrjetin e Pikave Kombëtare të Kontaktit të programit të BE-së H2020- NCP :

- a) Rrjeti i Pikave Kombëtare të Kontaktit do të krijohet, funksionojë dhe financohet nën përgjegjësinë e Shteteve Anëtare dhe vendeve kandidate që marrin pjesë në Programin Kuadër të BE për Kërkimin Shkencor e Inovacionin (H2020). Duke patur parasysh specifikat e çdo vendi, autoritetet përkatëse duhet të garantojnë të paktën përmbushjen e standarteve minimale dhe parimeve drejtuese të këtyre NCP.

- b) Autoriteti përkatës në nivel kombëtar, do të jetë përgjegjësi i vetëm për emërimin e Pikave Kombëtare të Kontaktit, në përputhje me strukturat e përbashkëta.
- c) Një Koordinator Kombëtar i Pikave Kombëtare të Kontaktit-NC do të bashkëpunojë me autoritetin kombëtar për sa i përket funksionimit të sistemit të NCP. Duke bërë këtë, Koordinatori Kombëtar do të ketë një njohuri më të gjërë të sistemit kombëtar të pikave të kontaktit, duke garantuar edhe një bashkëveprim dhe lidhje të tyre me strukturat përkatëse të Komisionit Europian për sa i përket rasteve të pyetjeve me karakter ndërsektorial të fushave të kërkimit shkencor. Këtu përfshihet edhe trajnimi po ashtu edhe realizimi i objektivave që iu përkasin të gjithëve, të tilla si barazia gjinore në kërkimin shkencor etj.
- d) Cdo autoritet kombëtar duhet të garantojë, që janë marrë masat për një funksionim sa më të lehtë të sistemit të Pikave Kombëtare të Kontaktit-NCP brenda vendit, duke përfshirë kapacitete të majftueshme administrative, monitorim të ecurisë dhe efektivitetit të tyre në përputhje me standartet minimale.
- e) Duhet hartuar rregulla të forta për të garantuar konfidencialitetin dhe për të shmangur konfliktin e interesit në përputhje me legjislacionin vendas. Në emërimin e NCP, është e rëndësishme të shmangen situata të tilla, që mund të çojnë më vonë në konflikte të mundshme të interesit, veçanërisht në kushte kur organizata që ka në varësi një prej Pikave Kombëtare të Kontaktit mund të jetë vetë aplikanti i një projekt propozimi të mundshëm. Nëse një organizatë që vepron si NCP, është edhe aplikant në H2020) duhet marrë masa parandaluese brenda vetë institucionit nëse shihet e nevojshme (për shembull, dallimi mes departamenteve që janë të përfshira në paraqitjen e projektpropozimeve me ato që janë përgjegjës për funksionin e NCP, (*kjo pikë nuk zbatohet në rastin kur thirrjet për projektpropozime u drejtohen vetë NCP, psh. krijimi i rrjeteve të NCP ndërmjet vendeve të ndryshme*).
- f) Cdo vend pjesëmarrës duhet të krijojë një bashkëpunim me ENN (Rrjetin Europian të Ndërmarrjeve), duke marrë parasysh rrethanat e tij specifike. Kjo do të përfshinte krijimin e një shërbimi one stop shop për SME-të, veçanërisht ato që janë krijuar së fundmi, duke i drejtuar aplikantët e mundshëm në këtë fushë drejt atij shërbimi që i përshtatet më shumë.
- g) Autoritetet përkatëse kombëtare në secilin vend duhet të krijojnë një faqe web portal për H2020 apo aty ku është e mundur ta realizojnë këtë duke shfrytëzuar faqet web portal ekzistuese. Portali duhet të përfshijë logot e BE-së dhe H2020, referencat kryesore dhe lidhjet (apo links) me të gjithë shërbimet mbështetëse në nivel kombëtar (të cilat mund të kenë nga ana e tyre websitein e tyre përkatëse). Portali

duhet të ofrojë një pikë të vetme hyrje për të gjithë pjesëmarrësit në këtë program, duke përfshirë SME-të, veçanërisht ato që janë të reja për programet e BE-së. Komisioni European do të krijojë një ëbsite mbi atë, me emrin EUROPA, që lidhet drejtpërdrejt me portalet kombëtare të H2020.

- h) Komisioni European do të lehtësojë organizimin dhe funksionimin e rrjetit të Pikave Kombëtare të Kontaktit të H2020, duke ofruar kordinimim aty ku është e nevojshme dhe duke ndihmuar që të garantohet përmbushja e standarteve minimale dhe parimeve drejtuese
- i) Vendet e treta ftohen gjithashtu që të emërojnë NCP në përputhje me strukturën e përbashkët.

Për cdo Pikë Kombëtare të Kontaktit të programit H2020

- j) Puna e Pikave Kombëtare të Kontaktit, do të drejtohet nga parimet e transparencës dhe aksesit të barabartë të informacionit, që duhet të ofrojnë gjithkujt lidhur me në thirrjet për projektpropozimet e H2020
- k) Pikat Kombëtare të Kontaktit të H2020 duhet të mbështeten brenda institucioneve të tyre respektive, ku ata janë të vendosur ose nga autoritetet kombëtare, qoftë me staf apo paisje, në atë masë që kjo ndihmë përputhet me qëllimin e mandatit dhe madhësinë e strukturës ku funksionon kjo pikë kontakti.
- l) Shërbimi i NCP duhet të jetë i aksesueshëm përmes e-mailit dhe telefonit dhe me elementë të tjerë komunikimi në rastet e mungesës fizike. Kjo duhet të përfshijë edhe një kuti postare në emër të NCP.
- m) Cdo NCP duhet të jetë i mirëinformuar me objektivat, parimet dhe përmbajtjen e atij programi apo seksionit brenda H2020, për të cilën ai është emëruar si specialist i kësaj fushe në kuadër të rrjetit të NCP.
- n) NCP duhet të kenë njohuri edhe për të gjitha aspektet e Horizon2020 përtej fushës tyre të kërkimit shkencor, duke lejuar në këtë mënyrë që të jenë dera e duhur ku mund të trokasin të gjithë të interesuarit, që kërkojnë një informacion mbi H2020.
- o) NCP duhet të jenë të paktën të informuar për mundësitë e ofruara nga programet e tjera kuadër të BE, që lidhen me kërkimin shkencor e inovacionin (psh COSME , ESIF) dhe të jenë të familjarizuar lidhur me burimet e duhura të informacionit se cili prej institucioneve në vend, ofron këshilla në raste të tilla (psh Autoriteti Menaxhues i këtyre programeve, në rastin e COSME, Ministria e Ekonomisë).
- p) Të gjitha NCP duhet të krijojnë marrëdhënie dypalëshe me ENN (Rrjetin European të Ndërmarrjeve), si një mundësi për të ofruar mbështetje njëri tjetrit, në përputhje me strukturat që janë në nivel kombëtar.
- q) NCP-të duhet të jenë bashkëbisedues të mirë dhe të jenë në gjendje të përshtasin metodat e duhura duke marrë parasysh larminë e aktorëve,

- që përbëjnë strukturën institucionale me të cilën lidhet H2020 (psh akademia, industria duke përfshirë SME, autoritetet publike etj).
- r) Në përputhje me natyrën bashkëpunuese që kanë programet e BE-së dhe në raport me qëllimet e Zonës Europiane të Kërkimit Shkencor (ERA), NCP-të duhet të jenë të gatshëm të marrin pjesë aktivisht në rrjete me karakter ndërkombëtar. Ata mund të përfitojnë si trajnerë apo të trajnuar, si të jetë më e përshtatshme.
 - s) Në përputhje me legjislacionin kombëtar, rrjeti i NCP-ve duhet të garantojë që informacioni konfidencial, që u vjen atyre, të trajtohet në mënyrën e duhur.
 - t) NCP-të duhet të jenë të cilruara nga konflikti i interesit përse i përket aktivitetit si NCP dhe pjesës tjetër, që ata kryejnë në funksione të tjera. NCP-të nuk duhet të caktohem si vlerësues të projektopozimeve, që paraqiten në kuadër të H2020.

4. Funksionet themelore të një NCP-je

1. Informimi, rritja e ndërgjegjësimit

- Të qarkullojë dokumentacionin e përgjithshëm dhe specifik lidhur me H2020 duke përfshirë kushtet për pjesëmarrje në këtë program, mundësitë dhe kushtet për paraqitjen e projektopozimeve, hartimin e buxhetit të projektit dhe mënyrat e raportimit
- Të organizojë aktivitete informuese e promovuese në bashkëpunimi me strukturat përkatëse të Komisionit European, kur është e nevojshme, të tilla si ditë informative, konferenca, newsletters, website, panaire, etj.
- **Të rrisë ndërgjegjësimin për :**
- Aktivitetet e inovacionit në H2020, duke përfshirë objektivin për të rritur e forcuar më tej pjesëmarrjen e sektorit të industrisë dhe SME-ve.
- Mundësitë e financimit që ofrohen përmes masave të tjera veçanërisht, iniciativat që parashikohen nga Nenet 185 dhe 187 të Traktatit të BE-së dhe ato që lidhen me Institutin European të Teknologjisë e Inovacionit (EIT) dhe Komunitetet e Dijes e Inovacionit (KIC), brenda qëllimit specifik që ka mandati i një NCP.
- Natyrën ndërdisiplinore të programit Horizon 2020, veçanërisht përse i përket atyre fushave të kërkimit shkencor, që lidhen me ofrimin e rrugëzgjidhjeve ndaj sfidave shoqërore që prekin vendet pjesëmarrëse.

- Objektivat që lidhen me rritjen e numrit të pjesëmarrjes së grave në programin H2020 dhe forcimin e lidhjeve mes shkencës dhe shoqërisë civile.
- Aktivitetet e Qendrës së Përbashkët të Kërkimit Shkencor (JRC), (një shërbim nga shkencëtarët për nevojat e politikave sektoriale të Komisionit Europian), ndaj aktorëve në nivel kombëtar, ku përfshihet komuniteti shkencor, industria dhe autoritetet publike.

Të ofrojë informacion kur është i nevojshëm, mbi programet e tjera të BE, që lidhen me kërkimin shkencor, zhvillimin e inovacionin, të tillë si COSME, Eureka, COST, dhe ato programe të ngjashme që janë pjesë e Fondeve Strukturore e të Kohezionit të BE përmes krijimit të lidhjeve të punës, me shërbimet e strukturat e specializuar brenda Komisionit Europian.

Ndihma, këshillimi dhe trajnimi

- Të asistojë studiuesit dhe organizatat që merren me kërkim shkencor, në veçanti aktorët e rinj dhe SME-të, në mënyrë që të rritet pjesëmarrja e tyre përmes aplikimeve në H2020
- Të asistojë në aktivitetet e H2020, ku kërkohen partnerë në fushën e kërkimit shkencor duke përdorur mjetet që ofron interneti, rrjetet që janë krijuar, shërbimin për partneritet të Rrjetit Europian të Ndërmarrjeve-(ENN), etj.
- Të këshillojë grupet e interesuara mbi procedurat, rregullat dhe çështjet administrative të programit H2020 (psh roli dhe përgjegjësitë e pjesëmarrësve në një konsorcium, kostot, të drejtat dhe detyrimet e pjesëmarrësve, rregullat e parimet etike të përcaktuara në Rekomandimet e Komisionit Europian, lidhur me Kartën Europiane për Kërkuesit Shkencorë dhe Kodin e Sjkelljes për Punësimin e Tyre (Charter for Researchers and Code of Conduct for their Recruitment). Aty ku është e nevojshme, kjo të kryhet në bashkëpunim me specialistin e çështjeve Ligjore e Financiare të NCP-ve.
- Të këshillojë pjesëmarrësit në këtë program, veçanërisht organizatat më të vogla dhe SME-të, për mënyrën e përcaktimit të strukturave të duhura ligjore e ato të menaxhimit lidhur me projektet me buxhet të madh dhe numrin e pjesëmarrësve në to.
- Të shpjegojë qëllimin dhe mënyrat e skemave të financimit që përdoren në H2020.

- Të organizojë kurse e sesione trajnimi për H2020, aty ku është e nevojshme për të shumëfishuar informacionin, ndërmjetësimin e garantuar në një cilësi të lartë këshillimi për personat e interesuar.

- Të organizojë kurse e seminare trajnimi për grupe specifike, që mund të jenë pjesëmarrës të mundshëm në programin H2020 (SME-të, universitetet, organizatat e biznesit, gratë studiuuese etj), ose për tema të veçanta (aspektet ligjore, mënyrat e pjesëmarrjes , fushat e kërkimit shkencor dhe inovacionit, që mbulohen nga programet e shumta dhe specifike, rregullat e financimit , etj).

Identifikimi dhe bashkëpunimi

- Të identifikojnë shërbime të tjera mbështetëse ndaj atyre pjesëmarrësve potencialë që kërkojnë asistencë, psh mbi çështjet e përgjithshme të BE-së, apo çështjeve të tjera që lidhen me tregun e brendshëm, transferimin e teknologjisë, të drejtat e pronësisë intelektuale (IPR), apo zhvillimin rajonal që merret me këto rrjete (psh EEN, EIB , Fondet Strukturore, Your Europe, Solvit etj).
- Të identifikojnë mundësitë dhe programet e financimit në nivel kombëtar dhe projektet e ERA Net.

5. Bashkëpunimi mes NCP dhe strukturave përkatëse të Komisionit Europian

Komisioni Europian, i konsideron NCP-të partnerë të rëndësishëm për zbatimin e programit H2020 dhe strukturën kryesore për ofrimin e informacionit praktik dhe ndihmën që mund tu japë aplikantëve të mundshëm.

Aspektet kryesore të bashkëpunimit

Komisioni Europian do të :

- Ofrojë informacion të përgjithshëm dhe të specializaur lidhur me mandatin e NCP-ve.
- Ftojë NCP-të, të marrin pjesë në aktivitete informuese dhe ndërgjegjësuese, që organizohen nga strukturat e Komisionit Europian, duke rimbursuar udhëtimin e shpenzimet e tyre, në përputhje me rregullat dhe politikën e Komisionit.
- Ftojë NCP-të, në konferenca e seminare tematike, që organizohen nga DG R&I dhe aty ku është është e mundur do të rimbursojë shpenzimet e tyre të pjesëmarrjes.
- Të ofrojë informacionin sa më shpejt që të jetë e mundur, mbi Programet e Punës/Work Programmes dhe Hartat e Rrugës/Road Map të fushave të kërkimit shkencor, që janë pjesë e H2020, për thirrjet e projektpropozimeve, ndryshimet në prioritetet e procedurat

administrative, statistika për projektet e vlerësimet e tyre, informacion mbi projektet e financuara, duke synuar një cilësi të lartë të informacionit.

- Hartojë periodikisht me kordinatorët kombëtarë të NCP-ve, një program për kurse trajnimi të përgjithshëm dhe specifike me NCP-të, duke kordinuar e monituruar zbatimin e tij.
- Të informojë NCP-të, rreth rezultateve të cdo ftese të mundshme për të paraqitur shprehje interesi.
- Të ofrojë fletëpalosje, broshura dhe materiale të tjera për tu shpërndarë nga NCP-të.
- Të ofrojë të dhëna dhe informacionin e nevojshëm për mënyrën e funksionimit të NCP-së. Në vecanti kordinatorët e NCP-ve, të vendeve anëtare të BE dhe vendeve kandidate do të marrin menjëherë informacion mbi rezultatin e vlerësimit të projektpropozimeve pasi të jetë informuar Komiteti i Programit (Programme Comittee), , në të njëjtën mënyrë si ai informacion që u ofrohet anëtarëve të Komitetit të Programit Programme Comittee), të H2020.
- Aty ku është e mundur dhe në përputhje me kuadrin ligjor, NCP-të, në vendet e treta do të marrin të dhëna të përpunuara për vlerësimin e projektpropozimeve, që janë paraqitur nga vendet e tyre dhe të dhëna të përzgjedhura mbi këto projektpropozime.

Aspektet praktike

Komisioni Europian do të:

- Emërojë persona kontakti për NCP-të në strukturat përkatëse të Komisionit Europian , duke pasqyruar strukturën e NCP-ve.
- Identifikojë një pikë kontakti, për të inkurajur marrëdhëniet mbështetëse mes NCP-ve dhe EEN.
- Krijojë dhe mirëmbajë një hapësirë në faqen web për NCP-të, duke ofruar informacion për ata dhe për të shërbyer si një forum diskutimi.
- Mbështesë rrjetet ndërshtetërore të NCP-ve, si një mjet për të nxitur bashkëpunimin Europian në fushën e kërkimit dhe inovacionit dhe si një kontribut për të realizuar Unionin e Inovacionit dhe Zonën Europiane të Kërkimit Shkencor (ERA).
- Garantojë, që NCP-të të jenë plotësisht të informuar mbi rregullat e rimbursimit për NCP-të, që ndjekin takime dhe të përditësojë vazhdimisht informacionin rreth tyre. Kjo do të shpjegohet sërish çdo NCP-je, në rastet e ftesave për të marrë pjesë në këto aktivitete.
- Aty ku është e mundur, NCP në vendet e treta do të ftohen të marrin pjesë në aktivitetet e përmendura më sipër, por nuk do të marrin

ndonjë mbështetje financiare nga Komisioni Europian, përsa kohë marrëveshja me këto vende nuk parashikon dicka tjetër.

Ruatja dhe përmirësimi i cilësisë

- Krijimi i rrjeteve ndërkombëtare të NCP-ve, mes shteteve të ndryshme pjesëmarrëse në H2020, do të nxisë ruajtjen e standarteve minimale dhe forcon kompetencat e tyre kur është e nevojshme.
- Për rrjetin e NCP-ve, Komisioni Europian do të organizojë takime të kordinatorëve kombëtarë të NCO-ve, për të ofruar një mundësi për të diskutuar bashkëpunimin, mbështetur në standaretet minimale, për të ndarë eksperiencat dhe për të identifikuar praktikat më të mira dhe për tu dhënë zgjidhje problemeve. Programi i trajnimit i përmendur më sipë, do të realizohet në këtë kontekst.
- Takimet do të përfshijnë një ftesë për kordinatorët kombëtarë të NCP, për të përshkruar mësimet e nxjerra nga monitorimi në nivel kombëtar.
- Kur ftohen ta bëjnë këtë nga një kordinator i NCP-ve të një vendi të cakatur, një ose më shumë vende pjesëmarrëse mund të ndërmarrin një “ vlerësim miqësor /friendly peer review” të sistemit të NCP-ve të këtij vendi, mundësisht përmes një projekti.
- Krijimi i rrjeteve ndërkombëtare të NCP-ve, mes shteteve të ndryshme pjesëmarrëse, me qëllim përcaktimin e objektivave të matëshme të funksionimit dhe duke bërë rekomandime për përmirësime të mëtejshme. Qasja që do të përdoret, do të zhvillohet më tej në takimet e kordindantorëve kombëtarë të NCP-ve.

Emërimi dhe procesi i njohjes

Emrat dhe detajet e kontaktit (adresa, telefon, e-mail) duhet të dërgohen zyrtarisht në emër të autoriteteve kombëtare, që janë përgjegjës për menaxhimin e H2020. Këto njoftime duhet ti drejtohen Drejtorit të Përgjithshëm për Kërkim e Inovacion në Komisionin Europian, dhe një kopje i drejtohet zyrtarit, që është ngarkuar me kordinimin e tyre.

Cdo ndryshim i mundshëm në personat që janë emëruar si NCP, duhet të komunikohet në të njëjtën mënyrë. Megjithatë vetëm ndryshimet e adresave të kontaktit (e jo personat e emëruar), mund ti dërgohen strukturës përkatëse kordinuese të NCP në Komisionin Europian.

Komisioni Europian do të publikojë listën e NCP-ve të emëruara në databasen e tij on-line të NCP-ve dhe referuar këtij database, ai do ta përfshijë atë në udhëzuesit për aplikantët dhe materiale të tjera informuese.

Nëse bëhet e qartë se një NCP ose një grup NCP, dështojnë të përmbushin këto standarte minimale, strukturat përkatëse të Komisionit European do ta ngrenë këtë çështje pranë kordinatorit kombëtar të NCP-ve ose pranë autoriteteteve kombëtare të vendit përkatës, nëse është e nevojshme. Qëllimi do të jetë, për të përcaktuar sesi të përmirësohet sa më mirë funksioni i tyre dhe të propozohen veprimet e duhura.

Në rast se shfaqen probleme ose të një sjellje të papëlqyer, Komisioni European do të informojë autoritetin kombëtar (dhe/ose Përfaqësuesin e Përhershmëm të shtetit përkatës në Bruksel). Nëse është e nevojshme, pasi është konsultuar për herë të parë me autoritetin kombëtar, NCP nuk do të njihet më si i tillë (de-recognised) dhe autoritetit përkatës kombëtar do ti kërkohet të bëjë zëvendësimin e NCP.

“ Procesi i mosnjohjes së NCP (de-recognised)”, nënkupton që NCP do të hiqet nga e-mail lista dhe nuk do të marrë më informacion të drejtpërdrejtë nga Komisioni, duke përfshirë çdo informacion konfidencial. NCP-ja nuk do të figurojë më tej ne website përkatës të BE-së.

7. Konfidencialiteti

Komisioni European do të kërkojë një deklaratë me shkrim nga autoriteti përkatës kombëtare të NCP, e cila duhet të pohojë se janë marrë të gjithë masat e nevojshme përta i përket ruajtjes së informacionit konfidencial (psh rezultati i vlerësimeve të projekt-propozimeve).